



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.21/2018

Prishtinë, më 10 maj 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Miljana Nikoliq, Saranda Bogujevci, Frashër Krasniqi, Mexhide Mjaku-Topalli, Mirjeta Kalludra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Teuta Haxhiu dhe Albulena Balaj Halimaj.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Visar Bivolaku-EUO/EUSr, Bekim Kodraliu-OSBE, Sanije Berisha-OSBE, Edmond Nikolla, Faik Sylaj, dhe Fatjon Gegaj-Fakulteti Juridik-UP, Amire Qamili-BIRN dhe Besiana Bajrami-Ekonomia Online.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Shqyrtimi i Raportit përfundimtar për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-031 për lirinë fetare në Kosovë;
2. Njoftim i Komisionit funksional, lidhur me shqyrtimin e peticioneve nga grupi punues;
3. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi i Raportit përfundimtar për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-031 për lirinë fetare në Kosovë

Kryetarja, tha se ky projektligj, me amendamentet e propozuara, ka kaluar edhe nëpër komisionet e përhershme të Kuvendit: Komisioni për Legjislacion e ka përkrahur amendamentin e propozuar nga deputeti Nait Hasani, në Komisionin për Komunitete, anëtarët e Listës Serbe kanë votuar kundër. Ky raport do të procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.

Teuta Haxhiu, tha se në këtë projektligj kemi punuar shumë, propozim-amendamentet e Listës Serbe i kemi pranuar 12 prej tyre, ndërsa ato që janë konsideruar antikushtetuese nuk është dashur të vijnë deri te ne, në komision. Është në interes të gjithë neve të kemi një ligj, punën e kemi përfunduar, por është mirë të finalizohet edhe me miratimin në Kuvend.

Miljana Nikoliq, në fillim tha se nuk janë 15 amendamente, por janë 14 të propozuara nga Lista Serbe, prej të cilave 11 sosh kanë të bëjnë me çështje gjuhësore të përkthimit në gjuhën serbe. Prej amendamenteve të propozuara, 7 sosh janë pranuar nga komisioni, ndërsa 4 nuk janë pranuar nga Komisioni funksional.

Në vazhdim, ajo numëroi amendamentet që nuk janë përkrahur nga Komisioni funksional. Më tej, ajo iu referua nenit 57 të Rregullores së Kuvendit, që ka të bëjë me shqyrtimin e Projektligjit në komision, ku siç tha ajo, vetëm propozim-amendamentet e bëra nga Lista Serbe dhe Qeveria e Kosovës, janë bërë sipas afateve të parapara.

Lista Serbe nuk do të votojë amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, sepse siç tha ajo, Komisioni funksional nuk ka të drejtë të propozojë amendamente, pas afatit dyjavor nga leximi i parë i projektligjit në Kuvend.

Duda Balje, tha se nuk janë shkelur procedurat e Rregullores së Kuvendit. Ajo lexoi nenin 57 të Rregullores së Kuvendit, që thekson se kush ka të drejtë të bëjë propozim-amendamente dhe se për shqyrtimin e një projektligji komisioni ka të drejtë në afat shtesë. Ajo tha se kemi punuar drejt dhe nuk kemi shkelur Rregulloren, dhe nëse arsye e Listës Serbe është shkelja e Rregullores e nuk janë kundër këtij projektligji, atëherë mund t'i paraqesim të gjitha këto në letër dhe mund të kërkojmë interpretim se a kemi bërë shkelje apo jo, por jam e sigurt se nuk ka shkelje gjatë shqyrtimit të këtij projektligji.

Miljana Nikoliq, tha se amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, vështirë se mund të pranohen nga Lista Serbe, por gjithashtu edhe projektligjin në tërësi nuk do ta pranojmë.

Duda Balje, tha se në Kosovë i kemi 6 konfesionet fetare dhe nuk jemi këtu që të marrim parasysh vetëm interesat e Listës Serbe dhe ju si anëtarë e këtij Kuvendi duhet punuar për të mirën e të gjithëve, e jo vetëm për serbet. Edhe në Kushtetutë flitet për komunitetet, e komunitete në Kosovë nuk janë vetëm serbët, dhe nuk jeni pronar i komuniteteve në Kosovë.

Teuta Haxhiu, tha se në dëgjimin publik që e ka organizuar Komisioni funksional për këtë projektligj, nuk kanë qenë prezentë përfaqësuesit e kishës ortodokse, kanë pasur ftesë, amendamentet tjera janë votuar prej të gjithë anëtarëve. Lidhur me kërkesën për të pasur zëvendës drejtor të zyrës, kemi biseduar me përfaqësues të Qeverisë dhe nuk na lejohet neve për të krijuar vend të ri të punës, pasi që nuk ekziston si pozitë. Propozimi i Komisionit funksional thotë: „Së paku 1 (një) anëtar i Komisionit për regjistrimin e bashkësive të reja fetare do të jetë nga komuniteti serb i Kosovës, ndërsa 1 (një) anëtar do të jetë nga komunitetet të tjera pakicë”, që i bie dy nga komunitetet, që prapë është diskriminim, por komisioni e ka pranuar. Është në kompetencë të Kryetarit të Kuvendit t’i zgjedhë tre deputetë, sipas kërkesës së bashkësisë fetare. Nga dëgjimi publik kemi ardhur në përfundim, që përfaqësuesit nga bashkësitë fetare që kanë qenë prezentë, varësisht kërkesës prej cilës bashkësi fetare vjen për regjistrim, deputetët që i dërgon Kuvendi, shkojnë nga ai komunitet.

Luljeta Veselaj-Gutaj, tha se këtë projektligj e kemi trajtuar shumë gjatë. Po ashtu, jemi munduar ta kuptojmë edhe kolegen Miljana Nikoliq, duke i dhënë hapësirë propozimeve të saj. Ne jemi këtu për t’i respektuar të gjitha të drejtat e komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Këtu pash raportin e Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, ku thuhet se Projektligji nr.06/L-001 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë, së bashku me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Dhe kjo tregon qartë që kemi punuar me përkushtim, mirë dhe drejt, brenda afateve ligjore që janë të parapara dhe e lus kolegen të bashkëbisedojë edhe një herë me grupin e vet parlamentar, duke pasur parasysh rëndësinë e projektligjit dhe të kemi mirëkuptim, në mënyrë që ta votoni projektligjin edhe në Kuvend.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se procedurat e shqyrtimit kanë qenë në rregull. Grupi punues me kompetencë ka shqyrtuar amendamentet e paraqitura dhe ka vlerësuar që shumicën t’i përkrahë, dhe për një amendament që ka mundësi të rregullohet me udhëzim administrativ në të ardhmen, besoj që nuk ka peshë për të kundërshtuar miratimin e këtij projektligji. Është interes i të gjithëve edhe i juaji, që së bashku ta mbështesim miratimin e këtij projektligji.

Frashër Krasniqi, tha se grupi i Partisë Social Demokrate të Kosovës, nuk jemi kundër ligjit në tërësi, por nuk do të mund ta votojmë, për shkak të disa pikave që konsiderojmë që janë problematike si neni 4A, ku te bashkësitë fetare, kisha ortodokse cilësohet si kishë ortodokse serbe, jemi kundër që të etnizohen fetë, jemi kundër refuzimit që i ka bërë komisioni amendamentit të deputetit Nait Hasani. Po ashtu, te numri i anëtarëve që nevojitet të regjistrohet një bashkësi fetare, tha se logjika është njëjtë si 50, si 100 anëtarë dhe prapë është numër shumë i vogël për të krijuar bashkësi fetare.

Më tej, tha se është kundër amendamentit, fshihet pika 3 e nenit 12A, Qeveria nuk financon asnjërin prej bashkësive fetare dhe mendoj se kjo është në rregull dhe nuk është dashur të bëhet amendament për ta fshirë. Këto janë arsyet që ne nuk do të mund ta votojmë këtë projektligj as në komision, as në Kuvend.

Saranda Bogujevci, tha se jemi Komision për të Drejtat e Njeriut, dhe nëse shohim propozimin që e kemi pranuar për anëtarët e komisionit, kemi bërë diskriminim shumë të madh, sepse komunitetit serb i jepet prioritet dhe një anëtar të jetë nga komunitetet e tjera apo vetëm në Kuvend i kemi të përfaqësuar 6 komunitete, por edhe nëse e shikojmë proporcionin e përbërjes së popullatës, është edhe një diskriminim tjetër. Në fakt, si komision, jemi munduar të bëjmë më të mirën e mundshme, vetëm për të çuar projektligjin përpara.

Miljana Nikoliq, tha se mendoj që nuk janë diskriminuese amendamentet e propozuara nga Lista Serbe, që kanë të bëjnë me harmonizimin gjuhësor. Më pas, ajo iu referua nenit 61 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, mbi përfaqësimin në punësim në institucionet publike.

Saranda Bogujevci, theksoi se për shkak të sqarimit, në këtë nen të Kushtetutës flitet për komunitetet, ndërsa nuk po e specifikon ndonjërin ose vetëm një komunitet.

Duda Balje, tha se në Kushtetutë, në asnjë vend nuk shkruan serbët, dhe nëse serbët kërkojnë dy anëtarë edhe unë do të kërkoj dy anëtarë. Këtu nuk ka kufi, sa i përket pozitës së zëvendës drejtorit nuk ekziston pozitë e tillë dhe nëse bëhet atëherë ligji ka implikime buxhetore, ne si komision nuk jemi kompetent për këtë.

Miljana Nikoliq, lidhur me mosprezencën në dëgjim publik të përfaqësuesit të kishës ortodokse serbe, tha se është bërë gabim në rastin e thirrur të personit të autorizuar.

Kryetarja, lidhur me këtë çështje, sqaroi se në dëgjim publik nga ana e përfaqësuesit të kishës ortodokse serbe është ftuar personi i autorizuar, emri, mbiemri dhe e-mail adresa e të cilit në komision është sjellë pikërisht nga Lista Serbe dhe i njëjti është ftuar si të gjithë të tjerët, por nuk i është përgjigjur ftesës.

Më pas, kryetarja hodhi në votim Raportin përfundimtar për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-031 për lirinë fetare në Kosovë.

Rezultati i votimit ishte:

Për- 8 deputetë,
Abstenim- 0 deputet,
Kundër- 2.

Më pas, kryetarja konstatoi se Komisioni funksional vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Komisioni funksional i rekomandon Kuvendit miratimin e Projektligjit nr.06/L-001 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë, me amendamentet e propozuara.

2. Njoftim i Komisionit Funksional lidhur me shqyrtimin e Peticioneve nga Grupi Punues

Kryetarja, tha se kemi njoftimin lidhur me shqyrtimin e tri peticioneve nga grupi punues. Ajo, më tej i njoftoi anëtarët e komisionit me procedimin e peticioneve të parashtruara nga:

- studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (UP), të përfaqësuar nga Donjeta Mejtani dhe Ermal Berisha;

- Boguljub Staletoviç, ish- zëvendës i Avokatit të Popullit dhe

- Islam Krasniqi.

Pas kësaj, anëtarët e komisionit u pajtuan, lidhur me procedimin e tri kërkesave të lartpërmendura.

3. Të ndryshme

Luljeta Veselaj-Gutaj, njoftoi se grupi punues për monitorimin e Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi. Ajo theksoi se nga data 11 maj 2018, do të fillojmë me vizita nëpër institucione qendrore dhe lokale dhe ftoi të gjithë anëtarët e komisionit, sipas mundësive, të marrin pjesë në takimet e parapara sipas planit të veprimit.

Lirije Kajtazi, tha se ka gatishmëri që kur të vizitohet ZQM, njëkohësisht, të bëhet edhe monitorimi i Ligjit për barazi gjinore.

Teuta Haxhiu, propozoi që së bashku me Komisionin Qeveritar për Persona të Zhdukur dhe Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, të shkojmë në Mejë dhe t'i vizitojmë varrezat, të shohim shqetësimin e qytetarëve ,sepse kanë vërejtje se ndërtimi i atyre varrezave nuk është bërë mirë dhe si komision të shohim se si është puna e atij kompleksi memorial.

Saranda Bogujevci, tha se nga agjencia, paraprakisht të kërkohet një raport apo një listë e monumenteve që ata i menaxhojnë, e pastaj të shkojmë si komision, por pasi të kemi dokumentacionin dhe atëherë të bëjmë krahasimin e asaj që është paraqitur me shkrim edhe realitetit në terren.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se është dashur të formohet një komision edhe nga deputetët dhe të monitorohet se si po kryhen punët e atyre ndërtimeve.

Albulena Balaj-Halimaj, tha se do të ishte mirë njëherë t'i kemi disa të dhëna, si komision, e pastaj t'i ftojme ose edhe të shkojmë në terren dhe të shohim si është gjendja.

Kryetarja konstatoi se komisioni kërkon nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, një raport me shkrim, lidhur me listën e memorialëve që janë ndërtuar, që janë në proces të ndërtimit, si dhe mirëmbajtja e tyre në tërësi dhe të ftohen në mbledhjen e radhës, Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur dhe Agjencia për Menaxhimin Komplekseve Memoriale.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,
Duda Balje